



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2023-10

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 3 shtator 2024

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

## Vendim për Caktimin e Trupit Gjykues I

---

### Gjykatësve të Trupit Gjykues I:

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatëse Mapi Feld-Folia

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula (rezervë)

**Mbrojtjes së Sabit Januzit:**

Xhonatan Elistan Ris

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Kimberli P. Uest

**Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit:**

Felisiti Geri

**Mbrojtjes së Haxhi Shalës:**

Tobi Kadman

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), në bazë të neneve 33(1)(b) dhe 40(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 98(3) dhe 115 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve"), cakton Trupin Gjykues I pas njoftimit nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake se dosja e plotë e kësaj çështjeje gjyqësore do të jetë gati për t'iu kaluar Trupit Gjykues më 4 shtator 2024 ("Njoftimi").<sup>1</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 2 tetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër z. Sabit Januzi dhe z. Ismet Bahtijari, versioni i redaktuar i së cilës u bë publik më 12 tetor 2023.<sup>2</sup>

2. Më 5 tetor 2023, z. Januzi dhe z. Bahtijari u arrestuan në Kosovë në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 2 tetor 2023<sup>3</sup> dhe më 6 tetor 2023 u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.<sup>4</sup>

3. Më 4 dhjetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër

---

<sup>1</sup> F00464, Njoftim në përputhje me Rregullën 98(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, 3 shtator 2024.

<sup>2</sup> Shih F00008, Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës, 2 tetor 2023 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*); F00008/RED/COR, Version i Korrigjuar i Redaktuar Publik i Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës, 12 tetor 2023.

<sup>3</sup> Shih F00009/A01, Fletarrestim për Sabit Januzin, 2 tetor 2023 (konfidencial); F00009/A03, Fletarrestim për Z. Ismet Bahtijari, 2 tetor 2023 (konfidencial). Versionet e redaktuara publike të fletarrestimeve u lëshuan më 12 tetor 2023. Shih F00009/A01/RED dhe F00009/A03/RED.

<sup>4</sup> Shih F00014, Njoftim për Pranimin e Ismet Bahtijarit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara me një Shtojcë Rreptësisht Konfidenciale dhe *Ex Parte*, 6 tetor 2023; F00015, Njoftim për Pranimin e Sabit Januzit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara me një Shtojcë Rreptësisht Konfidenciale dhe *Ex Parte*, 6 tetor 2023. Njoftimet u bënë publike më 10 nëntor 2023.

z. Haxhi Shala, versioni i redaktuar i së cilës u bë publik më 30 janar 2024.<sup>5</sup>

4. Më 11 dhjetor 2023, z. Shala u arrestua në Kosovë në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 4 dhjetor 2023<sup>6</sup> dhe më 12 dhjetor 2023 u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.<sup>7</sup>

5. Më 8 shkurt 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi kërkesën e Prokurores së Specializuar për të bashkuar çështjen e z. Januzi dhe Bahtijari me atë të z. Shala.<sup>8</sup>

6. Më 3 shtator 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake dorëzoi Njoftimin.<sup>9</sup>

## II. CAKTIMI

7. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

### KRYETARJA CAKTON TRUPIN GJYKUES I,

#### I PËRBËRË NGA:

**Gjykatës Roland Dekers**

**Gjykatëse Mapi Feld-Folia**

**Gjykatës Zhilber Biti**

**Gjykatës Vladimir Mikula (rezervë)**

---

<sup>5</sup> KSC-BC-2023-11/F00005, Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës, 4 dhjetor 2023; KSC-BC-2023-11/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës, 30 janar 2024.

<sup>6</sup> Shih KSC-BC-2023-11/F00006/A01, Fletarrestim për Haxhi Shalën, 4 dhjetor 2023 (konfidencial). Versioni i redaktuar publik i fletarrestimit u lëshua më 28 shkurt 2024. Shih F00006/A01/RED.

<sup>7</sup> Shih KSC-BC-2023-11/F00011, Njoftim për Pranimin e Haxhi Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara me një Shtojcë Rreptësisht Konfidenciale dhe *Ex Parte*, 12 dhjetor 2023. Njoftimi u bë publik po atë ditë.

<sup>8</sup> F00161, Vendim mbi Kërkesën për Bashkimin e Çështjeve Gjyqësore dhe Ndryshimin e Aktakuzës, 8 shkurt 2024 (konfidencial). Versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë. Shih F00161/RED.

<sup>9</sup> Shih Njoftimin.

për këtë çështje gjyqësore pas kalimit të dosjes gjyqësore më 4 shtator 2024.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova**  
**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E martë, 3 shtator 2024  
Në Hagë,  
Holandë